



Prishtinë, 28 shkurt 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1118_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.10, Nenit 30, Nenit 32 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, dhe Nenit 36 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 33 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085)
- Dispozitat e Nenit 4, Nenit 20, të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla Nr.07/2017);
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Furnizimit me Energji Elektrike (2017), si dhe
- Kërkesën e dorëzuar në Rregullator me datë 30.01.2019 nga ndërmarrja "HEP Energjia" SH.P.K., me adresë: Luan Haradinaj, Hyr. 1-2, Nr. 21, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 28 shkurt 2019, nxori këtë:

VENDIM

- I. **I NDRYSHOHET** emri ndërmarrjes së licencuar për Furnizim me energji elektrike nga "HEP-KS SH.P.K" në "HEP Energjia" SH.P.K. në Licencën për Furnizim me energji elektrike, me numër ZRRE/Li_43/15, të lëshuar me datë 14.10.2016 (e vlefshme për periudhën nga data 14 tetor 2016 deri 13 tetor 2021).
- II. Përveç ndryshimit në Kreun I, pika 1 të Licencës për Furnizim me energji elektrike numër ZRRE/Li_43/15 të lëshuar me datë 14.10.2016, të gjitha dispozitat tjera të licencës mbesin në fuqi.

Arsyetim

- o Përfaqësues të HEP Energjia SH.P.K me datë 30 janar 2019 kanë dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (Rregullator) Deklaratë për ndryshim të emrit të licencës nga HEP – KS SH.P.K në "HEP Energjia" SH.P.K.



- "HEP-KS" SH.P.K ka qenë e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë me numër biznesi 70865815 dhe e njëjta ka qenë edhe e licencuar nga Rregullatori, me numër licence ZRRE/Li_43/15.
- Përfaqësues të së njëjtës ndërmarrjeje kanë dorëzuar Certifikatën e regjistrimit të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë për "HEP Energjia" SH.P.K. me numër biznesi 70865815 i cili numër është identik me atë të "HEP-KS" SH.P.K.
- Në dëshminë e dërguar nga përfaqësues të ndërmarrjes në fjalë, është potencuar se *"të gjitha dokumentet e dorëzuara në Rregullator të emër të HEP – KS SH.P.K do të vlejnë tanimë për ndërmarrjen "HEP Energjia" SH.P.K., dhe se për çdo ndryshim të ndonjë dokumenti të dorëzuar gjatë aplikimit për licence, "HEP Energjia" SH.P.K. do të njoftojë Rregullatorin"*.
- Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit, dhe legjislacionit në fuqi dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes "HEP Energjia" SH.P.K.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Selifajaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar